

VENDIM
Nr. 188, datë 16.11.2020

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KAMIÇAN”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 1860 kW**

(ndryshuar me vendimet nr. 259, datë 21.12.2021; nr. 209, datë 27.6.2023; nr. 291, datë 9.10.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”, dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 119/5 prot., datë 12.11.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi aplikimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 154, datë 18.9.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamışan” me kapacitet të instaluar 1860 kW.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, në datën 22.9.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “IDI 2005” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1073/1 prot., datë 22.9.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1073/2 prot., datë 28.9.2020, si dhe me shkresën nr. 1073/4 prot., datë 26.10.2020 dhe nr. 1073/5 prot., datë 28.10.2020, ka plotësuar kryesisht dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., ka paraqitur kontratën nr. 621 rep., nr. 116/3 kol., datë 21.5.2020, “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Kamışan’, me kapacitet 1860 kW, në përroin e Kamışanit dhe përroit të Bistës, me derdhje në lumin Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan”, e lidhur midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe mbajtësit të miratimit “IDI 2005” sh.p.k.

- Shoqëria ka depozituar në ERE raportin e oponencës teknike, të kryer për projektin e zbatimit të HEC “Kamışan”, dërguar nga AKBN-ja, me shkresën e saj nr. 4362/4 prot., datë 31.7.2017 dhe të miratuar nga MIE me miratimin përfundimtar nr. 3157/1 prot., datë 16.4.2020.

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka depozituar në ERE kontratën e qirasë “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik” me nr. 1322 prot., datë 28.2.2018, e lidhur midis Bashkisë Elbasan, në cilësinë e qiradhënësit, dhe shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit.

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka depozituar në ERE edhe kontratën e qirasë “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik” me nr. 7126 prot., datë 10.12.2017, e lidhur midis

Bashkisë Gramsh, në cilësinë e qiradhënësit, dhe shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit.

- Të dyja këto kontrata i fillojnë efektet ligjore dhe financiare në momentin e pajisjes së shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., me lejen e ndërtimit të HEC “Kamëçan”.

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka përcjellë në ERE “Miratimin për pikë lidhje për HEC ‘Kamëçan’” me nr. 440/1 prot., datë 23.1.2019, lëshuar nga OSHEE sh.a., nga i cili rezulton se HEC “Kamëçan”, me kapacitet të instaluar 1680 kW, do të lidhet me rrjetin e shpërndarjes në zbarat 35 kV, në nënstacionin Gramsh.

- U konstatua se kapaciteti i HEC, i pasqyruar në këtë miratim (1680 kW), është i ndryshëm nga ai i kontratës me MIE-n (1860 kW). Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1073/5 prot., datë 28.10.2020, ka informuar se ka vënë në dijeni OSHEE sh.a., me shkresën datë 28.10.2020, për konstatimin e gabimit material, duke sqaruar se kapaciteti i miratuar në pikën e lidhjes, duhet të jetë i njëjtë me atë të kontratës së koncesionit të miratuar nga MIE.

- Shoqëria ka paraqitur “Leje për përdorim të burimit uhor” me nr. 1196 prot., datë 30.10.2018, të miratuar nga KBU Seman, me vendimin nr. 18, datë 25.10.2018, për shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., me qëllim përdorimin e burimit të ujit për prodhim energjie, e vlefshme deri në datën 25.10.2023.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE “Vendim për VNM-në paraprake”, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 614 prot., datë 11.2.2020, me nr. 7 vendimi, për personin juridik “IDI 2005” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin: Ndërtim i Hec-it ‘Kamëçan’”.

Në përmbajtjen e “Vendim për VNM-në paraprake”, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 614 prot., datë 11.2.2020, me nr. 7 vendimi, për personin juridik “IDI 2005” sh.p.k. “Për të zhvilluar projektin: Ndërtim i Hec-it ‘Kamëçan’”, në lidhje me afatin kohor të vlefshmërisë së vendimit që e ka miratuar atë, citohet në pikën 3.78 të saj, se: “Nëse veprimtaria nuk fillon zbatimin në terren brenda dy viteve, nga data e miratimit të vendimit për VNM-në, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i pajisjes me VNM-në fillon nga e para.”.

- Bazuar në nenin 11, të rregullores së sipërcituar, ERE mund të kërkojë çdo dokumentacion shtesë që i shërben procesit të licencimit, dhe për qëllime të këtij miratimi, momenti i fillimit të fuqisë juridike të lejeve të cituara më sipër, në varësi të kohës së miratimit të lejes së ndërtimit, e bën këtë të fundit, një dokument të nevojshëm për përlllogaritjen e afateve ligjore të tyre.

Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”. Plotësuar.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”. Plotësuar.

- Dokumentacioni teknik për HEC. Neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat: “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. Plotësuar.

- Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5, germat: “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamëçan”, me kapacitet të instaluar 1860 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. të depozitojë në ERE:

a) Brenda datës 19.9.2032, kontratën e rinovuar “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, të lidhur me Bashkinë Elbasan, si dhe kontratën e rinovuar “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, të lidhur me Bashkinë Gramsh, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në territorin ku shtrihet projekti i HEC Kamiçan.

b) Brenda datës 29.6.2028, lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kamiçan”.

3. Mos plotësimi i kushteve të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, përbën shkak për rishikimin e vendimit nga ERE.

4. *Shfuqizuar.*

5. *Shfuqizuar.*

6. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti